

## Abstrakt

Trajtimi i temës është bërë krahas nevojës për sçarim dhe analizë të gjerë juridike dhe krahasuese sa i përketë mbarimit të parakohëshëm të mandatit të presidentit si çështje e pranishme në sistemin tonë për një periudhë të gjatë, gjatë këtijë trajtimi janë zgjedhur shumë konkluzione dhe polemika sa i përketë mbarimit të parakohëshëm të mandatit, pasojave dhe zgjedhjeve pas mbarimit të parakohëshëm të mandatit, në këtë punim janë trajtuar raste të ndryshme të mbarimit të parakohëshëm të mandatit të presidentit duke i analizuar në aspekte juridike dhe krahasuese përmes metodës normative, krahasuese dhe historike. Analizimi i rasteve të ndryshme si rasti Pacolli, Sejdiu si dhe dorëheqja e presidentit, mos arritja e zgjedhjes së presidentit, aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe mungesa e përkohëshme e presidentit, ushtruesit e detyres së Presidentit dhe shumë çështje lidhur me këto janë shtjelluar me gjërësisht duke u bazuar gjithnjë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe legjislacionin në fuqi, duke mos lënë anash as Kushtetutën e Shqipërisë, Malit të Zi, Italisë, Maqedonisë së Veriut dhe Francës, gjithashtu edhe librat e ndryshme të cilat i kam cituar në punim, duke mos u zgjeruar më shumë, vlenë të ceket edhe fakti që punim përmban informacione të reja dhe përfundim konkret në rastet konkrete.